

Statistikat afatshkurtra

Tremujori II, 2015

Tiranë, më 28 Shtator: INSTAT publikon "Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike" për tremujorin e dytë 2015 sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 dhe me bazë të përditësuar, nga 2005 në 2010. Anketa mbulon aktivitetet: "Industri" (përfshi Industri nxjerrëse dhe Industri përpunuese), "Energji elektrike, gaz, avull", "Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë", "Ndërtim", dhe "Shërbime" (ku përfshihen Tregti, Transport dhe magazinim, Hotele, Informacion dhe Komunikim, Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike, Agjenci udhëtimi). (Shih shënime metodologjike, fq.18).


Indeksi i volumit të shifrës së afarizmit, vlerësuar me çmime fikse (2010=100) arriti 120,5 % në tremujorin e dytë 2015.

Ndryshimi vjetor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum pasqyron rritje prej 4,1 % në aktivitetet ekonomike të mbuluara në anketë, krahasuar me tremujorin e dytë 2014. Ky ndryshim në të njëjtin tremujor të vitit 2014 ishte me rritje 3 %. Në këtë rritje ndikuan kryesisht aktivitetet që kryhen në sektorët "Tregti" me 7,8 % dhe "Ndërtim", me 11,8 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e dytë 2015, paraqitet me rritje prej 13,8 % krahasuar me tremujorin e parë 2015. Në këtë rritje ndikuan kryesisht aktivitetet që kryhen në sektorët "Tregti" me 13,6 %, "Industri përpunuese" me 26 %, dhe "Ndërtim" dhe 25,4 %.


Fig.1 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum

(2010=100)



Për publikim 28/09/2015

Fig.2 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në Industri, Ndërtim dhe Shërbime



Tab. 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum, sipas aktivitetit ekonomik

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	II - 14 II - 13	III - 14 III - 13	IV - 14 IV - 13	I - 15 I - 14	II - 15 II - 14
	Aktivitetet ekonomike gjithsej	3,0	8,1	2,7	2,1	4,1
B+C	Industri	8,0	8,5	-4,5	-9,4	-1,5
B	Industri nxjerrëse	22,9	19,1	-16,2	-29,2	-30,9
C	Industri përpunuese	2,9	5,0	0,0	0,2	13,2
D	Energji elektrike, gaz, avull	3,7	14,4	30,6	21,0	3,2
E	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizim me ujë	28,5	9,7	11,6	27,9	22,8
F	Ndërtim	-11,6	16,2	19,3	7,3	11,8
G - N	Shërbime	4,8	5,3	-1,4	2,3	4,4
G	Tregti	6,1	7,7	0,3	6,0	7,8
H (49-53)	Transport dhe magazinim*	-43,3	-44,6	-15,0	-32,1	-34,0
I (551)	Hotele	16,3	24,8	19,8	-3,2	14,0
J (58-62)	Informacion dhe komunikim	19,2	11,8	-23,1	-20,2	-21,0
M (71)	Aktivite arkitekture dhe inxhinierike	9,3	14,1	56,2	2,1	24,9
N (79)	Agjenci udhëtimi	37,0	35,5	17,1	32,1	11,0

* Struktura e peshave për aktivitetet e mbuluara në Transport (Hekurudhor, detaj dhe ajror) edhe pse ka ndryshime si pasojë e mungesës së transportit ajror, nuk ka ndryshuar pasi peshat rishikohen për arsye metodologjike në periudhë t-2. Ndryshimet e indekseve të transportit ajror do të reflektohen në tremujorin e parë 2016. (për më shumë informacion shih Shënime metodologjike, fq 18)

Tab. 2 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum, sipas aktivitetit ekonomik

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	II - 14 I - 14	III - 14 II - 14	IV -14 III - 14	I -15 IV- 14	II -15 I - 15
	Aktivitetet ekonomike gjithsej	11,6	9,1	2,1	-17,9	13,8
B+C	Industri	13,2	3,7	-6,6	-17,3	23,0
B	<i>Industri nxjerrëse</i>	17,4	-2,1	-13,6	-28,7	14,6
C	<i>Industri përpunuese</i>	11,5	6,1	-3,9	-11,8	26,0
D	Energji elektrike, gaz, avull	0,4	-8,8	25,8	5,0	-14,4
E	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	9,5	-3,6	3,2	17,5	5,1
F	Ndërtim	20,4	4,7	24,6	-31,7	25,4
G-N	Shërbime	10,8	14,2	-1,6	-17,9	13,0
G	<i>Tregti</i>	11,7	14,1	-1,2	-15,8	13,6
H (49-53)	<i>Transport dhe magazinim</i>	19,6	21,7	-8,3	-49,2	16,3
I (551)	<i>Hotele</i>	39,1	15,8	-10,9	-32,6	63,9
J (58-62)	<i>Informacion dhe komunikim</i>	-1,0	14,7	-7,7	-23,9	-2,0
M (71)	<i>Aktivite arkitekture dhe inxhinierike</i>	4,6	2,1	27,0	-24,7	28,0
N (79)	<i>Agjenci udhëtimi</i>	19,7	16,6	-1,4	-4,0	0,6

Industri, Energji dhe Ujë

Në tremujorin e dytë 2015, **ndryshimi vjetor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetin “*Industri*” (përfshirë *Industri nxjerrëse dhe përpunuese*) ka rënë 1,5 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014. Ndikimin kryesor e jep aktiviteti “*Industri nxjerrëse*” me një rënie prej 30,9 %.

Referuar të njëjtës periudhë krahasimore, aktiviteti “*Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë*” paraqitet me rritje 22,8 %, ndërkohë aktiviteti “*Industri përpunuese*” me rritje 13,2 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetin “*Industri*”, paraqitet me rritje 23 % krahasuar me tremujorin paraardhës. Në këtë rritje ka ndikuar kryesisht aktiviteti “*Industri përpunuese*” me 26 %.

Aktiviteti “*Industri nxjerrëse*” shënoi rritje me 14,6 % dhe aktiviteti “*Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë*” shënoi rritje me 5,1 %.

Krahasuar me tremujorin e dytë 2014, **ndryshimi vjetor** i volumit të prodhimit industrial në “*Industri*” shënoi një rënie prej 1,2 %. Ndikimin kryesor e jep aktiviteti “*Industri nxjerrëse*” me një rënie prej 18,9 %.

Ndërsa, aktiviteti “*Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë*” shënoi rritje me 20,2 % dhe aktiviteti “*Industri përpunuese*” shënoi rritje me 16,8 %.

Gjatë tremujorit të dytë 2015, **ndryshimi tremujor** i volumit të prodhimit industrial shënoi një rritje me 19 % krahasuar me tremujorin paraardhës, ku ndikimin më të madh e ka dhënë “*Industri përpunuese*” me 31,5 %.

Referuar të njëjtës periudhë krahasimore, volumi i prodhimit shënoi rënie në aktivitetin “*Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë*” me 1 % dhe aktivitetin “*Energji elektrike, gaz, avull*” me 0,1 %.

Gjatë tremujorit të dytë 2015, **ndryshimi vjetor** i numrit të të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet që operojnë në aktivitetin “*Industri*” (*Industri nxjerrëse dhe përpunuese*) paraqet 3,4 % rritje krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Gjithashtu pati rritje në aktivitetin “*Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë*” me 15,2 % dhe në aktivitetin “*Energji elektrike, gaz, avull*” me 12,2 %.

Ndryshimi tremujor i numrit të të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e aktivitetit “*Industri*” rezulton 0 %.

Gjatë tremujorit të dytë 2015, **ndryshimi vjetor** i nivelit të fondit të pagave shënoi një rritje prej 4,2 % në “Industri”, ndryshim i cili vjen kryesisht nga rritja e këtij treguesi në aktivitetin “Industri përpunuese” me 7 %.

Ky tregues u rrit në aktivitetin “Energji elektrike, gaz, avull” me 1,3 % dhe në aktivitetin “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë” me 0,4 %.

Ndryshimi tremujor i fondit të pagave shënoi rënie me 2,1 % në aktivitetin “Industri”, rënie e cila vjen kryesisht nga ndikimi i aktivitetit “Industri nxjerrëse” me 7,9 % dhe nga aktiviteti “Energji elektrike, gaz, avull” me 4,3 %.

Gjithashtu, ky tregues shënoi rritje në aktivitetin “Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë”, me 4 %.

Fig. 3 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum dhe prodhimit industrial në volum në Industri nxjerrëse dhe përpunuese

(2010=100)




Fig. 4 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në Industri nxjerrëse, Industri përpunuese, Energji Elektrike dhe Grumbullimi dhe furnizimi me ujë

(2010=100)





Fig. 5 Sasia e prodhimit të Energjisë elektrike në (000/kw-orë)



Tab. 3 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
			II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
B-C	05-33	Industri	8,0	8,5	-4,5	-9,4	-1,5
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	22,9	19,1	-16,2	-29,2	-30,9
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	2,9	5,0	0,0	0,2	13,2
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	3,7	14,4	30,6	21,0	3,2
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	28,5	9,7	11,6	27,9	22,8

Tab. 4 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
			I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15
B-C	05-33	Industri	13,2	3,7	-6,6	-17,3	23,0
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	17,4	-2,1	-13,6	-28,7	14,6
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	11,5	6,1	-3,9	-11,8	26,0
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	0,4	-8,8	25,8	5,0	-14,4
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	9,5	-3,6	3,2	17,5	5,1

Tab. 5 Ndryshimi vjetor i Indeksit të volumit të prodhimit industrial në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
			II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
B-C	05-33	Industri	-0,6	4,5	-7,6	-22,4	-1,2
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-1,2	8,2	-21,9	-26,3	-18,9
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	-0,7	0,8	9,5	-18,5	16,8
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	-28,9	8,7	19,0	37,4	10,2
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	33,0	-3,0	13,3	56,8	20,2

Tab. 6 Ndryshimi tremujor i Indeksit të volumit të prodhimit industrial në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
	Rev.2		I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15
B-C	05-33	Industri	-6,6	8,0	-9,1	-15,4	19,0
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-4,6	12,7	-18,6	-15,8	5,0
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	-8,2	4,1	-0,6	-14,2	31,5
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	24,6	-44,0	48,6	32,4	-0,1
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	29,2	-0,7	1,8	20,1	-1,0

Tab. 7 Ndryshimi vjetor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
	Rev.2		II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
B-C	05-33	Industri	21,4	20,7	16,7	6,5	3,4
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-0,6	10,1	12,8	5,3	3,3
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	25,4	22,6	17,3	6,8	3,6
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	8,8	6,4	9,3	7,5	12,2
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	5,8	1,6	-2,2	17,2	15,2

Tab. 8 Ndryshimi tremujor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
	Rev.2		I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15
B-C	05-33	Industri	2,9	0,4	-0,5	3,5	0,0
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	0,4	9,4	-0,4	-3,8	-1,5
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	3,3	-0,9	-0,5	4,8	0,3
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	0,6	-1,1	1,8	6,1	5,1
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	2,0	-0,8	-2,7	19,1	0,3

Tab. 9 Ndryshimi vjetor i Indeksit të fondit të pagave në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
	Rev.2		II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
B-C	05-33	Industri	22,2	19,7	13,0	8,4	4,2
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	20,4	21,1	9,3	3,6	-1,9
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	22,8	19,1	15,8	10,7	7,0
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	24,3	13,1	14,9	12,3	1,3
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	7,3	9,6	-7,3	6,4	0,4

Tab. 10 Ndryshimi tremujor i Indeksit të fondit të pagave në Industri, Energji dhe Ujë

(%)

Seksioni	NVE	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
	Rev.2		I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15
B-C	05-33	Industri	1,8	2,0	2,5	1,8	-2,1
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	-2,7	7,5	3,5	-4,3	-7,9
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	4,0	-0,5	2,0	5,0	0,5
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	6,1	-2,9	3,1	5,7	-4,3
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	10,1	-6,2	-1,5	4,7	4,0

Ndërtimi

Në aktivitetin “Ndërtim”, **ndryshimi vjetor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e dytë 2015 paraqet një rritje prej 11,8 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014. Volumi i ndërtimit paraqet rritje prej 22,7 % krahasuar me të njëjtën periudhë.


Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “Ndërtim” në tremujorin e dytë 2015 paraqet rritje prej 14,1 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014, fondi i pagave, për ndërmarrjet që operojnë në aktivitetin “Ndërtim”, shënoi një rritje prej 20 % gjatë së njëjtës periudhë.

Në tremujorin e dytë 2015, **ndryshimi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, paraqet rritje prej 25,4 % krahasuar me tremujorin e parë 2015, ndërsaq volumi i ndërtimit është rritur me 27,8 % gjatë së njëjtës periudhë.

Në aktivitetin “Ndërtim” në tremujorin e dytë 2015 krahasuar me tremujorin e parë 2015 shënuan rritje, Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë me 3,9 % dhe Indeksi i fondi të pagave me 7,8 %.

Fig. 6 Indekset e shifrës së afarizmit në volum dhe volumit të ndërtimit

(2010=100)



Tab. 11 Ndryshimi vjetor i Indekseve të treguesve në Ndërtim

(%)

NVE Rev.2	Treguesit	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
		II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
41-43	Shifra e afarizmit	-11,6	16,2	19,3	7,3	11,8
	Volumi i ndërtimit	-14,7	13,8	21,1	17,1	22,7
	Të punësuar me pagesë	15,6	20,7	24,7	10,2	14,1
	Fondi i pagave	9,7	3,8	16,3	12,4	20,0


Tab. 12 Ndryshimi tremujor i Indekseve të treguesve në Ndërtim

(%)

NVE Rev.2	Treguesit	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
		I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15
41-43	Shifra e afarizmit	20,4	4,7	24,6	-31,7	25,4
	Volumi i ndërtimit	22,0	9,2	23,5	-28,8	27,8
	Të punësuar me pagesë	0,3	4,9	3,6	1,1	3,9
	Fondi i pagave	1,0	3,4	7,2	0,4	7,8

Fig. 7 Indeksi i volumit të ndërtimit në Ndërtime të reja, Rikonstruksione dhe Punime inxhinierike

(2010=100)



Shërbime

Në tremujorin e dytë 2015, **ndryshimi vjetor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetin “Shërbime” është rritur 4,4 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014, ndikuar kryesisht nga aktivitetet “Tregti me shumicë” me 9,3 %, “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike” me 24,9 % dhe “Agjenci udhëtimi” me 11 %.

Në tremujorin e dytë 2015 krahasuar me tremujorin e parë 2015, **ndryshimi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetin “Shërbime” është rritur 13 %. Në këtë rritje kanë ndikuar kryesisht aktivitetet “Tregti me shumicë” me 16,4 % dhe “Transport dhe magazinim” me 16,3 %.

Në tremujorin e dytë 2015, **ndryshimi vjetor** në aktivitetet “Shërbime” ka një rritje të numrit të të punësuarve me pagesë me 7,3 %. Kontributin më të madh në këtë rritje e kanë dhënë kryesisht aktivitetet “Tregti me shumicë” me 20,3 % dhe “Informacion dhe komunikacion” me 7 %.

Në tremujorin e dytë 2015, **ndryshimi tremujor** në ndërmarrjet që operojnë në “Shërbime” paraqet rritje të numrit të të punësuarve me pagesë me 0,6 %, krahasuar me tremujorin e parë 2015. Në këtë rritje kanë ndikuar kryesisht aktivitetet “Informacioni dhe komunikacion” me 5,2 % dhe “Transport dhe Magazinim” me 1,8 %.

Në aktivitetin “Shërbime”, **ndryshimi vjetor**, në tremujorin e dytë 2015, paraqet një rritje të fondit të pagave me 7,5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kontribut kryesor në rritjen e këtij treguesi kanë dhënë kryesisht aktivitetet “Tregti me shumicë” me 14,9 % dhe “Informacioni dhe komunikacion” me 16,1 %.

Ndryshimi tremujor i fondit të pagave paraqitet me rritje 1,4 % në tremujorin e dytë 2015 krahasuar me tremujorin e parë 2015, në aktivitetin “Shërbime”. Në këtë rritje kanë ndikuar kryesisht aktivitetet “Tregti me shumicë” me 0,3 % dhe “Informacioni dhe komunikacion” me 2,7 %.

Tregti me pakicë dhe shumicë dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe Tregtia me shumicë

Ndryshimi vjetor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në tremujorin e dytë 2015 krahasuar me tremujorin e dytë 2014, aktiviteti “Tregti me shumicë” paraqet rritje 9,3 % dhe aktiviteti “Tregti me pakicë dhe shumicë dhe riparimi i automjeteve e motoçikletave” paraqet rritje me 6,7 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, aktiviteti “Tregti me shumicë” paraqet rritje 16,4 % dhe aktiviteti “Tregti me pakicë dhe shumicë dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave” paraqet rritje me 3,2 %, në tremujorin e dytë 2015 në krahasim me tremujorin parë 2015.

Në tremujorin e dytë 2015, në ndërmarrjet që operojnë në aktivitetin “*Tregti me shumicë*”, **ndryshimi vjetor** i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë paraqet rritje 20,3 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Ndërsa, **ndryshimi tremujor** i këtij treguesi paraqet rënie 0,8 % krahasuar me tremujorin e parë 2015.

Në aktivitetin “*Tregti me shumicë*”, **ndryshimi vjetor**, në tremujorin e dytë 2015 paraqet një rritje të fondit të pagave me 14,9 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërkaq në aktivitetin “*Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve*” rritje me 2 %.

Në ndryshim tremujor, ky tregues paraqet rritje 0,3 % në aktivitetin “*Tregti me shumicë*”, ndërsa në aktivitetin “*Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve*” ka patur rënie me 0,7 % krahasuar me tremujorin e parë 2015.

Transport dhe Magazinim (përfshirë dhe aktiviteti “Postë”)

Në aktivitetin “*Transport dhe magazinim*”, shifra e afarizmit në volum ka shënuar rënie me 34 %, në tremujorin e dytë 2015 krahasuar me tremujorin e dytë 2014. Në aktivitetin “*Postë*”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum krahasuar me tremujorin e dytë 2014 paraqet rritje 16,4 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet “*Transport dhe magazinim*”, përfshirë dhe aktivitetin “*Postë*” ka shënuar rritje 16,3 %. Në aktivitetin “*Transport hekurudhor*”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum krahasuar me tremujorin e parë 2014 paraqet rritje 20,5 %.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “*Transport dhe magazinim*” paraqet rënie me 1,2 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Ndërsa, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “*Transport dhe magazinim*”, **në ndryshim tremujor**, shënoi rritje me 1,8 % krahasuar me tremujorin e parë 2015.

Referuar të njëjtit aktivitet, **ndryshimi vjetor** i indeksit të fondit të pagave paraqitet rënie 20,9 %.

Krahasuar me tremujorin e parë 2015, indeksi i fondit të pagave paraqitet me rritje 1,7 % në këtë tremujor në aktivitetin “*Transport dhe magazinim*” .

Hotele

Në aktivitetin “*Hotele*”, **ndryshimi vjetor** i shifrës së afarizmit në volum, paraqet rritje me 14 % në tremujorin e dytë 2015 krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Në tremujorin e dytë 2015, në aktivitetin “*Hotele*”, krahasuar me tremujorin e parë 2015, indeksi i shifrës së afarizmit në volum paraqet rritje 63,9 %.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në tremujorin e dytë 2015 paraqet rritje 11,7 %, ndërsa në **ndryshim tremujor**, krahasuar me tremujorin e parë 2015, ky tregues paraqet rritje 8,6 %.

Ndryshimi vjetor i fondit të pagave në ndërmarrjet e aktivitetit “*Hotele*” paraqet rritje 12,8% krahasuar me tremujorin e dytë 2015, ndërsa në **ndryshim tremujor**, krahasuar me tremujorin e parë 2015, ky tregues paraqet rritje 8,1 %.

Informacioni dhe Komunikacioni

Në aktivitetin “*Informacioni dhe Komunikacioni*”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum është ulur 21 % në tremujorin e dytë 2015 krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetet “*Informacioni dhe Komunikacioni*” paraqet rënie 2 % krahasuar me tremujorin e parë 2015.

Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë, në aktivitetin “*Informacioni dhe Komunikacioni*”, në **ndryshim vjetor**, paraqitet me rritje 7 % në tremujorin e dytë 2015 krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Ndryshimi tremujor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë referuar të njejtit aktivitet paraqet rritje 5,2 %.

Fondi i pagave në aktivitetin “*Informacioni dhe komunikacioni*” paraqitet me rritje 16,1 % në tremujorin dytë 2015 krahasuar me tremujorin e dytë 2014, ndërsa **ndryshimi tremujor** i indeksit të fondit të pagave paraqet rritje 2,7 % në krahasim me tremujorin e parë 2015.

Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike

Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në “*Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike*” rritet 24,9 % në tremujorin e dytë 2015 krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum paraqet rritje me 28 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “*Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike*” paraqet rënie 0,2 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2014, ndërsa në **ndryshim tremujor**, referuar të njëjtit aktivitet, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë paraqitet me rritje 1,2 %.

Ndryshimi vjetor i indeksit të fondit të pagave në aktivitetin “*Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike*” paraqet rritje 18 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Me rënie 1,2 % paraqitet indeksi i fondit të pagave në këtë tremujor, referuar të njëjtit aktivitet, krahasuar me tremujorin e parë 2015.

Agjenci udhëtimi

Në aktivitetin “*Agjenci udhëtimi*”, shifra e afarizmit në volum rritet 11 % në tremujorin e dytë 2015 krahasuar me tremujorin e dytë 2014.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum paraqet rritje 0,6 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “*Agjenci udhëtimi*” paraqet rritje 22,2 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014, ndërkaq edhe në **ndryshim tremujor**, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në këtë aktivitet paraqitet me rritje 15,3 % krahasuar me tremujorin e parë 2015.

Indeksi i fondit të pagave, në **ndryshim vjetor**, në aktivitetin “*Agjenci udhëtimi*” paraqitet me rritje 20,3 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014, ndërkaq në **ndryshim tremujor**, ky tregues paraqitet me rritje 7,2 % krahasuar me tremujorin e parë 2015.

Tab. 13 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Shërbime

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
		II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
G-N	Shërbime	4,8	5,3	-1,4	2,3	4,4
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	0,0	8,3	10,5	9,2	6,7
G(46)	Tregtia me shumicë	6,5	8,0	-0,8	6,6	9,3
H(49-53)	Transport dhe magazinim	-43,3	-44,6	-15	-32,1	-34,0
I(5500)	Hotele	16,3	24,8	19,8	-3,2	14,0
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	19,2	11,8	-23,1	-20,2	-21,0
M(71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	9,3	14,1	56,2	2,1	24,9
N(79)	Agjenci udhëtimi	37,0	35,5	17,1	32,1	11,0

Tab. 14 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Shërbime

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
		I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15
G-N	Shërbime	10,8	14,2	-1,5	-17,9	13,0
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	5,7	9,0	-0,5	-4,7	3,2
G(46)	Tregtia me shumicë	13,5	16,2	-2,2	-17,4	16,4
H(49-53)	Transport dhe magazinim	19,6	21,7	-8,3	-49,2	16,3
I(5500)	Hotele	39,1	15,8	-10,9	-32,6	63,9
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	-1,0	14,7	-7,7	-23,9	-2,0
M(71)	Aktivite arkitekture dhe inxhinierike	4,6	2,1	27,0	-24,7	28,0
N(79)	Agjenci udhëtimi	19,7	16,6	-1,4	-4,0	0,6

Tab. 15 Ndryshimi vjetor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Shërbime

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
		II - 13	III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14
G-N	Shërbime	18,1	15,2	12,8	13,4	7,3
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	17,4	3,9	10,5	18,1	5,8
G(46)	Tregtia me shumicë	12,8	17,6	15,1	22,8	20,3
H(49-53)	Transport dhe magazinim	-4,3	-2,9	4,6	-2,7	-1,2
I(5500)	Hotele	20,9	22,0	26,5	10,4	11,7
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	13,0	19,8	4,4	4,7	7,0
M(71)	Aktivite arkitekture dhe inxhinierike	37,7	21,6	3,8	3,7	-0,2
N(79)	Agjenci udhëtimi	2,7	-1,5	1,2	2,2	22,2

Tab. 16 Ndryshimi tremujor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Shërbime

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15	II - 15
		I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14	I - 15
G-N	Shërbime	6,2	-3,4	0,4	10,1	0,6
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	9,9	-11,8	7,3	13,5	-1,5
G(46)	Tregtia me shumicë	1,2	4,1	0,1	16,4	-0,8
H(49-53)	Transport dhe magazinim	0,3	1,2	0,0	-4,1	1,8
I(5500)	Hotele	7,4	12,1	-6,6	-1,8	8,6
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	3,0	-0,5	-4,4	6,9	5,2
M(71)	Aktivite arkitekture dhe inxhinierike	5,1	-10,0	9,2	0,3	1,2
N(79)	Agjenci udhëtimi	-3,5	2,0	0,9	3,0	15,3

Tab. 17 Ndryshimi vjetor i Indeksit të fondit të pagave në Shërbime

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 14 II - 13	III - 14 III - 13	IV - 14 IV - 13	I - 15 I - 14	II - 15 II - 14
G-N	Shërbime	11,0	9,1	8,8	9,2	7,5
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	7,9	-2,7	-1,2	8,9	2,0
G(46)	Tregtia me shumicë	14,9	18,0	16,7	20,6	14,9
H(49-53)	Transport dhe magazinim	-13,7	-23,4	-4,8	-19,0	-20,9
I(5500)	Hotele	16,7	20,6	23,4	10,2	12,8
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	17,7	23,7	12,3	5,7	16,1
M(71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	14,7	13,7	-9,6	13,1	18,0
N(79)	Agjenci udhëtimi	-10,1	-10,0	-5,7	12,0	20,3

Tab. 18 Ndryshimi tremujor i Indeksit të fondit të pagave në Shërbime

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	II - 14 I - 14	III - 14 II - 14	IV - 14 III - 14	I - 15 IV - 14	II - 15 I - 15
G-N	Shërbime	3,0	-4,1	4,0	6,2	1,4
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	6,1	-8,1	5,3	6,1	-0,7
G(46)	Tregtia me shumicë	5,3	0,6	-0,4	14,3	0,3
H(49-53)	Transport dhe magazinim	4,2	-5,3	1,4	-19,1	1,7
I(5500)	Hotele	5,6	12,9	-5,5	-2,2	8,1
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	-6,5	-6,3	16,9	3,2	2,7
M(71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	-5,3	0,2	3,9	14,7	-1,2
N(79)	Agjenci udhëtimi	-0,2	2,0	8,4	1,5	7,2

Metodologjia

Informacion

INSTAT si rrjedhojë e detyrimeve që ka ndaj Eurostat, për përshtatshmëri të plotë të statistikave shqiptare me ato të vendeve Europiane, publikon indekset e treguesve ekonomike si Shifër afarizmi, Prodhim, Numri i të punësuarve me pagesë dhe Paga për aktivitetet Industri, (ku përfshihen Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, gaz, avull; Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë; Ndërtim si dhe Shërbime, ku përfshihen (Tregti; Transport dhe magazinim; Hotele; Informacioni dhe komunikacioni; Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi).

Në Tregti, anketa mbulon aktivitetet Tregti me pakicë dhe shumicë dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe Tregti me shumicë. Treguesit e Tregtisë me pakicë publikohen më vete. Për më shumë informacion, linku: <http://www.instat.gov.al/al/themes/informacioni-ekonomik-për-ndërmarrjet/publication/books/2014/tregtia-me-pakicë,-t3-2014.aspx>;

Ndryshimet metodologjike i referohen:

- Aplikimit të Nomenklaturës së rishikuar të aktiviteve ekonomike, NVE Rev.2;
- Ri-peshimit, përditësohen peshat e përfaqësimit, nga ASN 2005 në ASN 2010 deri në vitin 2013. Sipas rekomandimeve të Eurostat-it dhe asistencës Suedeze është bërë përditësimi i peshava për vitin 2015 duke përdorur peshat ASN 2013, (t-2) sipas metodës Chain-link.
- Ri-referimit, përditësohet periudha referuese nga 2005=100 në 2010=100;

Aplikimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2, bëhet me akt ligjor të miratuar me VKM Nr 320 datë 28.05.2014.

Për më shumë shikoni linkun: http://www.instat.gov.al/media/248316/njoftim_per_media_-_ndryshimi_i_nomenklatur_s_s_veprimtarive_ekonomike_rev_2.pdf

Klasifikimi i rishikuar është në mënyrë të konsiderueshme i ndryshëm nga klasifikimi ekzistues në drejtim të strukturës, klasifikimit dhe trajtimit metodologjik të disa aktiviteve.

Kalimi i njërive statistikore nga NVE Rev.1.1 në NVE Rev.2 është bërë nëpërmjet ndërtimit të matricës së konvertuar, bazuar në informacionin statistikor të përfutur nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2010.

Referuar pikërisht kësaj matrice, disa nga grup-aktivitetet që janë publikuar me NVE Rev.1.1 përgjithësisht kalojnë 100 përqind në grup aktivitete publikimi në NVE Rev.2. Ndryshimet që kryesisht sjellë klasifikimi i ri për aktivitetet përbërëse të fushës së mbulimit të ATN, janë si më poshtë:

- a. Sipas klasifikimit të vjetër (NVE Rev. 1) aktivitetet e “Publikimit” përkojnë me ndarjen 22. Në klasifikimin e ri (NVE Rev. 2) “Aktivitete publikimi” përkon me ndarjen 58, seksioni J, “Informacioni dhe Komunikacioni”.
- b. Ndarja 45, që përkon me NVE Rev.1.1 në aktivitetin e “Ndërtimit”, detajohet në tre ndarje në klasifikimin e ri, në 41, “Ndërtimi i ndërtesave”, 42, “Punime inxhinierike” dhe 43 “Punime të specializuara ndërtimi”. Pjesë e ndarjes 41 bëhet edhe grupi 70.1 që përkon në NVE Rev.1.1, me aktivitetin “Aktivitete mbi pasuritë e patundshme”.
- c. Aktivitetet e postave dhe korrierës, që përkon në NVE Rev. 1.1, me klasat 64.11 dhe 64.12, kalon në aktivitetin “Transport dhe magazinim”, që përkon në NVE Rev.2 me ndarjen 58, “Aktiviteti i postës dhe korrierës”.
- d. Një tjetër risi e klasifikimit të ri, me ndikim në publikimin e indeksit të statistikave afatshkurtra (tremujore) është edhe ardhja në fushën e mbulimit të aktiviteteve si: “Grumbullimi dhe Trajtimi i mbeturinave”, që përkon me klasifikimin NVE Rev.1.1, ndarja 90. Në klasifikimin e ri, NVE Rev.2, këto aktivitete i përkojnë ndarjes 38, “Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve”. Bëhet pjesë e kësaj ndarje edhe grupi 38.3, që përkon në NVE Rev.1.1, me ndarjen 37, “Riciklimi”.
- e. Në grupin 71.00, që përkon në NVE Rev.2, me “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike, aktivitete të kontrolleve dhe analizave teknike”, përfshihen edhe aktivitete të veçanta të grupeve 74.3 -74.8, që përkon me NVE Rev.1.1 me “Aktivitete të kontrollit dhe analiza teknike”.

Treguesi kryesor i shifrës së afarizmit është përdorur për rivlerësimin e kalimit të aktiviteteve ekonomike nga nomenkatura e vjetër në nomenklaturën e re. Metodatat kryesore të përdorura për vlerësim janë dy:

- Metoda e vlerësimit në nivel mikro
- Metoda e vlerësimit në nivel makro

Metoda e parë, u përdor për tre vitet e para të riklasifikimit të aktiviteteve të njëjësive në nivel individual në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve, 2010-2012;

Metoda e dytë, u përdor për rivlerësimin e të dhënave në seri kohore pas, për periudhën 2005-2010.

Ri-peshimi – për reflektuar ndryshimet e strukturës së ekonomisë, peshat përditësohen, sipas metodologjisë së statistikave europiane sipas aktiviteteve përfaqësuese, nga 2005 në 2010.

Ri –referim - shprehimisht do të thotë kalimi i indekseve me një periudhë referuese të re, nga 2005=100 në 2010=100. Seritë e të dhënave, të llogaritura me të dy periudhat, janë ekuivalente me njëra-tjetrën: ritmet e rritjes janë të njëjta, dhe një seri mund të konvertohet tek tjetra.

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike (35)
- Grumbullim, trajtim dhe furnizim me ujë (36)
- Ndërtim (41, 42, 43)

Shërbime, të cilat përbëhen nga Tregtia me shumicë, Hotele, Transport dhe Magazinim, Agjenci udhëtimi, Komunikacion dhe Informacion dhe shërbime të tjera:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor, përfshi vetëm Hotele (55.1)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi me vit referues bazë, aktualisht 2010=100, ndryshim vjetor në përqindje, ndryshim tremujor në përqindje. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për aktivitetin hotelier, si dhe Shitjen dhe riparimin e automjeteve. Për aktivitetet e transportit përdoret deflator i llogaritur në mënyrë implicite nga të dhënat administrative. Indekset nuk janë të vlerësuara sezonalisht.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shifra e afarizmit - Shifra e afarizmit përfshin shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i Shifrës së afarizmit - Objektivi i indeksit të shifrës së afarizmit është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime nga një periudhe korente ndaj një periudhe bazë

Numri i të punësuarve me pagesë - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përfshirë të vetëpunësuarit me pagesë) nga një periudhe korente ndaj një periudhe bazë.

Indeksi i Numrit të punësuarve me pagesë - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar nga një periudhe korente ndaj një periudhe bazë.

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga një periudhe korente ndaj një periudhe bazë.